

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 230

DOKUMENTIMI I AUDITIMIT

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Natyra dhe Qëllimet e Dokumentimit të Auditimit	2-3
Hyrja në fuqi	4
Objektivi	5
Përkufizimet	6
Kërkesat	
Përgatitja në Kohë e Dokumentimit të Auditimit	7
Dokumentimi i Procedurave të Auditimit të Kryera dhe Evidencës së Auditimit të Marrë	8-13
Sistemimi i Dosjes Përfundimtare të Auditimit	14-16
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Përgatitja në Kohë e Dokumentimit të Auditimit	A1
Dokumentimi i Procedurave të Auditimit të Kryera dhe Evidencës së Auditimit të Marrë	A2-A20
Sistemimi i Dosjes Përfundimtare të Auditimit	A21-A24
Shtojcë: Kërkesa dhe Udhëzime Specifike të Dokumentimit të Auditimit në SNA-të e Tjera	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 230, "Dokumentimi i Auditimit" duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 "Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit".

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesit për përgatitjen e dokumentacionit të auditimit për auditimin e pasqyrave financiare. Shtojca rendit SNA-të e tjera që përmbajnë kërkesa dhe udhëzime specifike lidhur me dokumentimin. Kërkesat specifike për dokumentimin të SNA-ve të tjera nuk kufizojnë zbatimin e këtij SNA-je. Ligje ose rregullore mund të përcaktojnë kërkesa shtesë për dokumentimin.

Natyra dhe Qëllimet e Dokumentimit të Auditimit

2. Dokumentimi i auditimit që plotëson kërkesat e këtij SNA-je dhe kërkesat specifike për dokumentacion të SNA-ve të tjerë përkatës japin:
 - (a) Evidencë për bazat e audituesit për konkluzionin rreth arritjes së objektivave të përgjithshme të audituesit;¹ dhe
 - (b) Evidencë që tregon se auditimi është kryer në përputhje me SNA-të dhe kërkesat e zbatueshme ligjore e rregullatore.
3. Dokumentimi i auditimit i shërben edhe disa qëllimeve të tjera, ku përfshihen:
 - Ndhurma për grupin e auditimit në planifikimin dhe kryerjen e auditimit.
 - Ndhurma për anëtarët e grupit të auditimit të ngarkuar me mbikëqytjen, për të drejtuar dhe mbikëqyrur punën audituese dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të rishikimit në pajtim me SNA 220.²
 - Krijimi i mundësisë që grupi i auditimit të japë llogari për punën e tij.
 - Mbajtja e një regjistri të çështjeve me rëndësi të vazhdueshme për qëllime të auditimeve të ardhshme.
 - Krijimi i mundësisë që një auditues me eksperiencë të kryejë rishikime dhe inspektime për kontrollin e cilësisë në pajtim me SNKC 1³ ose kërkesat kombëtare që janë të paktën po aq kërkuese.⁴

¹ SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 11.

² SNA 220, *Kontrolli i Cilësisë për Auditimin e Pasqyrave Financiare*, paragrafët 15-17.

³ SNKC 1, *Kontrolli i Cilësisë për Kabinetet që Kryejnë Auditime dhe Rishikime të Pasqyrave Financiare dhe Angazhime të Dhënies së Sigurisë dhe Shërbime të Lidhura*, paragrafët 32-33, 35-38 dhe 48.

⁴ SNA 220, paragrafi 2.

- Krijimi i mundësisë që një auditues me eksperiencë të kryejë inspektime të jashtme në pajtim me kërkesat ligjore, rregullatore apo kërkesa të tjera.

Hyrja në Fuqi

4. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivi

5. Objektivi i audituesit është të përgatisë dokumentacionin që jep:
 - (a) Regjistrim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm të bazave për raportin e audituesit; dhe
 - (b) Evidencë që auditimi është planifikuar dhe është kryer në përputhje me SNA-të dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme.

Përkufizimet

6. Për qëllimet e SNA-ve, termat e mëposhtëm kanë kuptimin që u jepet në vijim:
 - (a) Dokumentimi i auditimit – Regjistrimi i procedurave të auditimit të kryera, evidenca përkatëse e auditimit e grumbulluar dhe konkluzionet e arritura nga audituesi (shpesh herë janë përdorur terma të tillë si “fletët e punës” ose “fletë pune”).
 - (b) Dosja e auditimit – Një ose më shumë skedarë ose media tjetër të ruajtjes, në formë fizike ose elektronike, që përmbajnë regjistrimet të cilat përfshijnë dokumentacionin e auditimit për një angazhim të veçantë.
 - (c) Auditues me eksperiencë – Një individ (pavarësisht nëse është brenda apo jashtë kabinetit), i cili ka eksperiencë auditimi praktike dhe njohje të arsyeshme të:
 - (i) Proceseve të auditimit;
 - (ii) SNA-ve dhe kërkesave të zbatueshme ligjore e rregullatore;
 - (iii) Mjedisit të biznesit në të cilin operon entiteti; dhe
 - (iv) Çështjeve të raportimit financiar e të auditimit që lidhen me sektorin e ekonomisë ku vepron entiteti.

Kërkesat

Përgatitja në Kohë e Dokumentimit të Auditimit

7. Audituesi përgatit dokumentacionin e auditimit në kohën e duhur. (Ref: Para. A1)

Dokumentimi i Procedurave të Auditimit të Kryera dhe Evidencës së Auditimit të Marrë

Forma, Përmbajtja dhe Shtrirja e Dokumentimit të Auditimit

8. Audituesi përgatit dokumentimin e auditimit në mënyrë të atillë që bën të mundur që një auditues me eksperiencë, por pa lidhje të mëparshme me auditimin në fjalë, të arrijë të kuptojë: (Ref: Para. A2-A5, A16-A17)

Natyren, afatet dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në zbatim të SNA-ve dhe të kërkesave të tjera ligjore e rregullatore; (Ref: Para. A6-A7)

- (a) Rezultatet e procedurave të auditimit dhe evidencën e auditimit të siguruar; dhe
 - (b) Çështjet e rëndësishme që kanë lindur gjatë auditimit dhe konkluzionet e arritura në lidhje me këto çështje dhe gjykimet profesionale të rëndësishme të bëra për këto konkluzione. (Ref: Para. A8-A11)
9. Gjatë dokumentimit të natyrës, afateve dhe shtrirjes së procedurave të auditimit të kryera, audituesi duhet të regjistrojë:
- (a) Karakteristikat identifikuese të zërave apo çështjeve të testuara; (Ref: Para. A12)
 - (b) Personat që kanë kryer punën audituese dhe datën e përfundimit të kësaj pune; dhe
 - (c) Personat që kanë rishikuar punën e auditimit të kryer dhe datën e shtrirjen e këtij rishikimi. (Ref: Para. A13)
10. Audituesi dokumenton diskutimet e bëra me drejtimin, me ata që janë ngarkuar me qeverisjen dhe me të tjerët, duke përfshirë çështjet e rëndësishme të diskutuara si dhe kohën kur dhe me cilët janë bërë diskutimet. (Ref: Para. A14)
11. Në rast se audituesi identifikon informacione, që janë në kundërshtim ose nuk janë në pajtueshmëri me konkluzionet e tij përfundimtare lidhur me një çështje të rëndësishme, audituesi dokumenton mënyrën e trajtimit të kundërshtisë ose të mospajtueshmërisë. (Ref: Para. A15)

Devijimi nga një Kërkesë e Rëndësishme

12. Kur, në raste përjashtimore, audituesi gjykon të nevojshëm devijimin nga një kërkesë e rëndësishme në ndonjë SNA, audituesi dokumenton mënyrën se si është arritur objektivi i auditimit në kushtet e procedurave alternative të auditimit edhe arsyet e këtij devijimi. (Ref: Para. A18-A19)

Çështje që Dalin mbas Datës së Raportit të Audituesit

13. Në qoftë se, në rrethana përjashtimore, audituesi kryen procedura auditimi të reja ose shtesë, apo arrin në konkluzione të reja pas datës së raportit të audituesit, audituesi dokumenton: (Ref: Para. A20)
- (a) Rrethanat që janë ndeshur;
 - (b) Procedurat e reja ose shtesë të auditimit që janë kryer, evidencën e auditimit të siguruar dhe konkluzionet e arritura, si dhe efektin e tyre në raportin e audituesit; dhe
 - (c) Kohën kur dhe nga kush janë bërë ndryshimet në dokumentimin e auditimit dhe (kur është e nevojshme) rishikimi i tyre.

Sistemimi i Dosjes Përfundimtare të Auditimit

14. Audituesi përfundon sistemimin e dokumentacionit në dosjen e auditimit dhe plotëson procesin administrativ të sistemimit të dosjes përfundimtare të auditimit në kohën e duhur pas datës së raportit të audituesit. (Ref: Para. A21-A22)
15. Pas kryerjes së sistemimit të dosjes përfundimtare të auditimit dhe deri në përfundim të periudhës së parashikuar për ruajtjen e saj, audituesi nuk lejohet të fshijë, ose të heqë dokumentet e auditimit të çdo lloji natyre përpara përfundimit të periudhës së ruajtjes së tij. (Ref: Para. A23)
16. Në rrethana përveç atyre që parashikohen në paragrafin 13, kur audituesi e gjykon të nevojshme të modifikojë dokumentimin ekzistues të auditimit ose të shtojë dokumente të reja të auditimit, pasi ka mbaruar procesi i sistemimit përfundimtar të dosjes, audituesi, pavarësisht nga natyra e modifikimeve apo shtesave, dokumenton: (Ref: Para. A24)
- (a) Arsyet specifike për bërjen e tyre; dhe
 - (b) Kur dhe nga kush janë bërë dhe (kur është e aplikueshme) rishikuar ato.

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Përgatitja në Kohë e Dokumentimit të Auditimit (Ref: Para. 7)

A1. Përgatitja e dokumentimit të nevojshëm të auditimit në kohën e duhur ndihmon në përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe lehtëson rishikimin e vlerësimin efikas të evidencës së auditimit të grumbulluar dhe të konkluzioneve të arritura përpara se të finalizohet raporti i audituesit. Dokumentimi i përgatitur gjatë kryerjes së punës ka të ngjarë të jetë më i saktë se sa dokumentacioni i përgatitur pas kryerjes së punëve të auditimit.

Dokumentimi i Procedurave të Auditimit të Kryera dhe Evidencës së Auditimit të Marrë

Forma, Përmbajtja dhe Shtrirja e Dokumentimit të Auditimit (Ref: Para. 8)

A2. Forma, përmbajtja dhe shtrirja e dokumentimit të auditimit varen nga faktorë të tillë si:

- Madhësia dhe kompleksiteti i entitetit.
 - Natyra e procedurave të auditimit që duhen kryer.
 - Rreziqet e identifikuara të anomalive materiale.
 - Rëndësia e evidencës së auditimit të siguruar.
 - Natyra dhe shtrirja e përjashtimeve të identifikuara.
 - Nevoja për të dokumentuar një konkluzion ose bazën për konkluzionin, e cila nuk mund të përcaktohet lehtë nga dokumentimi i punës së kryer apo nga evidenca e auditimit e siguruar.
 - Metodologjia dhe mjetet e auditimit të përdorura.
- A3. Dokumentimi i auditimit mund të regjistrohet në letër, ose në media elektronike, apo në një media tjetër. Shembuj të dokumentacionit të auditimit përfshijnë:
- Programet e auditimit.
 - Analizat.
 - Memorandumet e çështjeve.

- Përmbledhjet e çështjeve të rëndësishme.
- Letrat e konfirmimeve dhe të deklarimeve.
- Listat e kontrollit.
- Korrespondenca (perfshirë e-mailet) që kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme.

Si pjesë përbërëse e dokumentimit të auditimit mund të përfshihen abstraktet ose kopjet e regjistrave të entitetit, për shembull kontratat apo marrëveshjet e rëndësishme ose specifike, po qe se kjo konsiderohet e përshtatshme. Megjithatë, dokumentimi i auditimit nuk zëvendëson regjistrat kontabël të entitetit.

- A4. Audituesi përjashton nga dokumentimi i auditimit, projekt fletët e punës dhe projekt pasqyrat financiare që janë zëvendësuar, shënimet që reflektojnë mendime të paplota apo paraprake, kopjet e mëparshme të dokumenteve, të cilat janë korrigjuar për gabime ortografike ose gabime të tjera dhe dokumentet e dubluara.
- A5. Shpjegimet me gojë të bëra nga vetë audituesi, nuk përfaqësojnë mbështetje të mjaftueshme për punën e kryer apo për konkluzionet e arritura prej tij, por ato mund të përdoren për të shpjeguar ose qartësuar informacionet që përfshihen në dokumentimin e auditimit.

Dokumentimi i Përputhshmërisë me SNA-të (Ref: Para. 8(a))

- A6. Në parim, përputhshmëria me kërkesat e këtij SNA-je bën që dokumentacioni i auditimit të jetë i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për rrethanat. SNA-të e tjera përmbajnë kërkesa specifike të dokumentimit që synojnë të qartësojnë zbatimin e këtij SNA-je në rrethana të veçanta të atyre SNA-ve. Kërkesat e veçanta për dokumentacion të SNA-ve të tjerë nuk e kufizojnë zbatimin e këtij SNA-je. Për më tepër, mungesa e një kërkesë për dokumentacion në secilin prej SNA-ve nuk synon të sygjerohet se nuk ka dokumentacion që duhet të përgatitet si rezultat i zbatimit të atij SNA-je.
- A7. Dokumentimi i auditimit jep evidencë që auditimi është në përputhje me SNA-të. Por nuk është as e nevojshme dhe as praktike për audituesin që të dokumentojë çdo çështje të marrë në konsideratë, ose çdo gjykim profesional të bërë, në një auditim. Më tej, nuk është e nevojshme për audituesin të dokumentojë veças (si për shembull në një listë kontrolli) zbatimin ndaj çështjeve për të cilat është demonstruar përputhshmëria e tyre nga dokumentet e përfshira në dosjen e auditimit. Për shembull nëpërmjet këtyre dokumentave:
- Ekzistenca e një plani auditimi të dokumentuar përkatësisht demonstroi se audituesi ka planifikuar auditimin.

- Ekzistenca e një letre angazhimi të firmosur në dosjen e auditimit demonstroi se audituesi ka rënë dakord për kushtet e angazhimit të auditimit me drejtimin ose, kur është rasti, me ata që janë ngarkuar me qeverisjen.
- Raporti i audituesit që përmban një opinion me rezervë të përshtatshëm mbi pasqyrat financiare demonstroi që audituesi ka plotësuar kërkesat për të shprehur një opinion me rezervë sipas rrethanave të parashikuara në SNA-të.
- Në lidhje me kërkesat që zbatohen në përgjithësi gjatë gjithë auditimit, ka një numër mënyrash në të cilat përputhshmëria me to mund të demonstron në dosjen e auditimit:
 - Për shembull, nuk ka një mënyrë të vetme me të cilën dokumentohet skepticizmi profesional i audituesit. Por dokumentimi i auditimit megjithatë jep evidencë për ushtrimin nga audituesi të skepticizmit profesional në përputhje me SNA-të. Kjo evidencë duhet të përfshijë procedurat e veçanta të kryera për të mbështetur përgjigjet e drejtimit për pyetjet e audituesit.
 - Në mënyrë të ngjashme, që ortaku i angazhimit ka marrë përgjegjësinë për drejtimin, mbikqyrjen dhe kryerjen e auditimit në përputhje me SNA-të mund të evidentohet në një numër mënyrash në dokumentimin e auditimit. Kjo duhet të përfshijë dokumentacionin se ortaku i angazhimit ka marrë pjesë në kohën e duhur në aspektet e auditimit, të tilla si pjesëmarrja në diskutimet në grup që kërkohen nga SNA 315 (rëshikuar).⁵

Dokumentimi i Çështjeve të Konsiderueshme dhe Gjykimeve të Rëndësishme Profesionale Përkatëse (Ref: Para. 8(c))

A8. Vlerësimi i rëndësisë së një çështje kërkon një analizë objektive të fakteve e të rrethanave. Shembuj të çështjeve të konsiderueshme përfshijnë:

- Çështjet që çojnë në rreziqe të konsiderueshme (siç janë përshkruar në SNA 315 (i rishikuar)).⁶
- Rezultatet e procedurave të auditimit që tregojnë (a) se pasqyrat financiare mund të përmbajë anomali materiale, ose (b) për nevojën e rishikimit të vlerësimit të mëparshëm të audituesit lidhur me rreziqet e anomalive materiale dhe reagimin e tij ndaj këtyre rreziqeve.
- Rrethanat të cilat ja vështirësojnë audituesit zbatimin e procedurave të nevojshme të auditimit.

⁵ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij*, paragrafi 10.

⁶ SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 4(e).

- Faktet e gjetura që mund të çojnë në një modifikim të raportit të audituesit ose përfshirjen e një paragrafi me Çështje të Theksuar në raportin e audituesit.
- A9. Një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe shtrirjes së dokumentimit të auditimit të çështjeve të konsiderueshme është shtrirja e gjykimeve profesionale të ushtruara në kryerjen e punës dhe vlerësimin e rezultateve. Dokumentimi i gjykimeve profesionale të bëra, kur janë të konsiderueshme, shërben për të shpjeguar konkluzionet e audituesit dhe për të përforcuar cilësinë e gjykimeve. Këto çështje janë me rëndësi të veçantë për ata që janë përgjegjës për rishikimin e dokumentimit të auditimit, përfshirë ata që do të kryejnë auditime të mëpasshme kur çështjet e rishikuara kanë rëndësi në vijimësi (për shembull, kur kryen një rishikim retrospektiv të çmuarjeve kontabël).
- A10. Disa shembuj të rrethanave në të cilat, në përputhje me paragrafin 8, është e përshtatshme të përgatiten dokumentacione auditimi për përdorimin e gjykimeve profesionale përfshijnë, kur çështja dhe gjykimet janë të konsiderueshme:
- Llogjikën për konkluzionin e audituesit kur kërkesa parashikon që audituesi “duhet të marrë në konsideratë” informacione apo faktorë të caktuar, dhe që konsiderata është e rëndësishme në kontekstin e një angazhimi të veçantë.
 - Bazat për konkluzionin e audituesit për llogjikën e aspekteve të gjykimeve subjektive (për shembull, llogjika e çmuarjeve kontabël të konsiderueshme).
 - Bazat për konkluzionin e audituesit rreth vërtetësisë së dokumentit kur ndërmerret investigimi i mëtejshëm (i tillë si përdorimin përkatës të ekspertit ose të një procedure konfirmimi) në përgjigje të kushteve të identifikuar gjatë auditimit të cilat kanë bërë që audituesi të besojë se dokumenti nuk është origjinal.
 - Kur zbatohet SNA 701⁷ audituesi përcakton çështjet kryesore të auditimit ose që nuk ka asnjë çështje kryesore të auditimit për t`u komunikuar.
- A11. Audituesi mund të konsiderojë me dobi përgatitjen dhe mbajtjen, si pjesë përbërëse të dokumentimit të auditimit, të një përmbledhje (shpesh e njohur si memorandum përmbledhës) ku përshkruhen çështjet e rëndësishme të identifikuar gjatë auditimit dhe mënyra e trajtimit të tyre, ose që përfshin një referencë lidhëse me dokumentimin tjetër mbështetës të auditimit që siguron këtë informacion. Kjo përmbledhje mund të lehtësojë rishikimet dhe inspektimet efektive e efikase të dokumentimit të auditimit, veçanërisht për auditimet e mëdha e komplekse. Për më tepër, përgatitja e një përmbledhje të tillë mund të ndihmojë audituesin për të vlerësuar çështjet e rëndësishme. Gjithashtu kjo mund ta ndihmojë audituesin për të marrë në konsideratë nëse, në dritën e procedurave të auditimit dhe konkluzioneve të arritura, ka ndonjë objektiv përkatës të SNA-ve që audituesi nuk mund ta arrijë dhe që mund të pengojë atë në arritjen e objektivave të përgjithshme të audituesit.

⁷ SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

Identifikimi i Zërave ose Çështjeve të Veçanta të Testuara, dhe të Përgatitësit dhe të Rishikuesit (Ref: Para. 9)

A12. Regjistrimi i karakteristikave identifikuese shërben për shumë qëllime. Për shembull, ai mundëson që grupi i auditimit të japë llogari për punën e tij dhe lehtëson investigimin e përjashtimeve apo të mospërputhjeve. Karakteristikat identifikuese variojnë sipas natyrës së procedurës së auditimit dhe elementit apo çështjes që testohet. Për shembull:

- Për një testim të detajuar të urdhërave të blerjes të gjeneruara nga entiteti, audituesi mund të identifikojë dokumentet e zgjedhura për testim sipas datave dhe numrave unikë të urdhërave të blerjes.
- Për një procedurë që kërkon zgjedhjen apo rishikimin e të gjithë elementeve që tejkalojnë një shumë të caktuar, të marrë nga një popullatë e dhënë, audituesi mund të regjistrojë objektin e procedurës dhe të identifikojë popullatën (për shembull të gjitha regjistrimet në ditar mbi një shumë të caktuar të marrë nga regjistri i ditarit).
- Për një procedurë që kërkon një zgjedhje sistematike të një kampioni nga një popullatë, audituesi mund të identifikojë dokumentet e zgjedhura sipas burimit të regjistrimit, pikën e fillimit të intervalit të zgjedhjes së kampionit (për shembull, një kampion sistematik i raporteve të ngarkesave, i zgjedhur nga ditari i transportit për periudhën 1 prill deri me 30 shtator, duke nisur nga raporti me numër 12345 dhe duke zgjedhur një element në çdo 125 raporte).
- Për një procedurë që kërkon pyetjen e personelit specifik të entitetit, audituesi mund të regjistrojë datat kur anëtarët e këtij personeli janë pyetur dhe emrat e llojet e punës që kryhen prej tyre.
- Për një procedurë mbikëqyrëse, audituesi mund të regjistrojë procesin, apo çështjen në fjalë që është vëzhguar, individët përkatës, përgjegjësitë e tyre respektive dhe kohën e vendin ku është kryer vëzhgimi.

A13. SNA 220 kërkon që audituesi të rishikojë punën e kryer për auditimin nëpërmjet rishikimit të dokumentimit të auditimit.⁸ Kërkesa për të dokumentuar se kush e ka rishikuar punën e auditimit të kryer nuk imponon nevojën që për çdo fletë pune specifike të përfshihet evidenca e rishikimit. Megjithatë, dokumentimi i auditimit evidenton se kush i ka rishikuar elementet e specifikuar të punës së auditimit të kryer dhe kohën e rishikimit.

Dokumentimi i Diskutimeve për Çështjet e Konsiderueshme me Drejtimin, me Ata që Janë Ngarkuar me Qeverisjen dhe me të Tjerë (Ref: Para. 10)

⁸ SNA 220, paragrafi 17.

A14. Dokumentimi nuk kufizohet vetëm në regjistrimet e bëra nga audituesi, por mund të përfshijë edhe dokumente të tjera siç janë proces-verbalet e mbledhjeve të përgatitura nga personeli i entitetit dhe të rëna dakord me audituesin. Në personat e tjerë, me të cilët audituesi mund të diskutojë çështjet e rëndësishme përfshihen personat e ngarkuar me qeverisjen, personeli tjetër brenda entitetit, si edhe palët e treta, siç janë personat që i japin këshilla profesionale entitetit.

Dokumentimi se si Janë Trajtuar Mospërputhjet (Ref: Para. 11)

A15. Kërkesa për të dokumentuar se si janë trajtuar mospërputhjet në informacionin nuk e detyron audituesin të mbajë dokumente që nuk janë korrekte ose që janë zëvendësuar.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet më të Vogla (Ref: Para. 8)

A16. Dokumentimi i auditimit për auditimin e entiteteve më të vogla në përgjithësi është më pak i shtrirë se sa për auditimin e entiteteve të mëdha. Më tej, në rastin e një auditimi ku ortaku i angazhimit kryen të gjithë punën audituese, dokumentacioni nuk përmban çështje të cilat do të duhej të dokumentoheshin vetëm për të informuar apo udhëzuar pjestarët e grupit të angazhimit, ose për të dhënë evidencë për rishikimin nga një pjestar tjetër i grupit (për shembull, nuk ka përse të dokumentohen çështje që lidhen me diskutimin në grup ose mbikëqyrjen). Megjithatë, ortaku i angazhimit zbaton të gjitha kërkesat mbizotëruese në paragrafin 8 për të përgatitur dokumentimin e auditimit që është i kuptueshëm nga një auditues me eksperiencë, derisa dokumentimi i auditimit mund të jetë subjekt i rishikimit nga palë të treta për qëllime rregullatore ose të tjera.

A17. Kur përgatit dokumentimin e auditimit, audituesi i entitetit më të vogël gjithashtu mund ta konsiderojë të dobishme dhe efikase të regjistrojë disa aspekte të auditimit së bashku në një dokument të vetëm, me referencat e kryqëzuara për të mbështetur fletët e punës sipas rastit. Shembuj të çështjeve që mund të dokumentohen së bashku në auditimin e një entiteti më të vogël përfshijnë njohjen e entitetit dhe të kontrollit të tij të brendshëm, strategjinë e përgjithshme të auditimit dhe planin e auditimit, materialitetin e përcaktuar në bazë të SNA 320,⁹ rreziqet e vlerësuara, çështjet e konsiderueshme të marra shënim gjatë auditimit dhe konkluzionet e arritura.

Devijimi nga Kërkesat Përkatëse (Ref: Para. 12)

A18. Kërkesat e SNA-ve janë hartuar për t'i mundësuar audituesit të arrijë objektivat e veçanta të SNA-ve dhe nga kjo edhe objektivat e përgjithshëm të auditimit. Për rrjedhojë, me përjashtim të rasteve përjashtimore, SNA-të kërkojnë përputhshmëri me secilën kërkesë që është e përshtatëshme për rrethanat e auditimit.

⁹ SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e Auditimit*.

A19. Kërkesat për dokumentim zbatohen vetëm për kërkesat që janë përkatëse për rrethanat. Kërkesa nuk është përkatëse¹⁰ vetëm në rastet kur:

- (a) I gjithë SNA nuk është përkatës (për shembull, në qoftë se entiteti nuk ka një shërbim të auditimit të brendshëm, nga SNA 610 (i rishikuar në 2013)¹¹ asgjë nuk është përkatëse); ose
- (b) Kërkesa është e kushtëzuar dhe kushti nuk ekziston (për shembull, kërkesa për të modifikuar raportin e audituesit kur ka pamundësi për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe kur nuk ka ndonjë pamundësi të tillë).

Çështjet që Dalin pas Datës së Raportit të Audituesit (Ref: Para. 13)

A20. Shembuj të rrethanave përjashtimore përfshijnë faktet për të cilat audituesi merr dijeni pas datës së raportit të audituesit por të cilat kanë ekzistuar në atë datë dhe të cilat, në qoftë se do të ishin bërë të ditura në atë datë, do të shkaktonin ndryshime në pasqyrat financiare ose do të kishin modifikuar opinionin në raportin e audituesit.¹² Ndryshimet që vijnë në dokumentimin e auditimit rishikohen në përputhje me përgjegjësitë e rishikimit të parashikuara në SNA 220¹³ dhe me ortakun e angazhimit që merr përgjegjësinë përfundimtare për ndryshimet.

Sistemimi i Dosjes Përfundimtare të Auditimit (Ref: Para. 14-16)

A21. SNKC 1 (ose kërkesat në standardet kombëtare që janë të paktën po aq kërkuese) kërkon që firmat të vendosin politika e procedura, të cilat garantojnë përfundimin në kohë të sistemimit të dosjeve të auditimit.¹⁴ Periudha prej 60 ditësh pas datës së raportit të audituesit, si rregull përbën kufirin limit të kohës, brenda të cilës duhet të përfundohet dhe të sistemohet dosja përfundimtare e auditimit.¹⁵

A22. Përfundimi dhe sistemimi i dosjes përfundimtare të auditimit pas datës së raportit të audituesit është një proces administrativ, që nuk përfshin kryerjen e procedurave të reja të auditimit apo nxjerrjen e konkluzioneve të reja. Megjithatë, gjatë procesit përfundimtar të sistemimit në dokumentimin e auditimit mund të bëhen ndryshime, po qe se ato kanë natyrë administrative. Shembuj të këtyre ndryshimeve janë:

- Fshirja apo heqja e dokumenteve të zëvendësuara.
- Renditja, bashkimi apo bërja e referencave të kryqëzuara të fletëve të punës.

¹⁰ SNA 200, paragrafi 22.

¹¹ SNA 610 (i rishikuar në 2013), *Përdorimi i Punës së Audituesve të Brendshëm.*, paragrafi 2

¹² SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonëshme*, paragrafi 14.

¹³ SNA 220, paragrafi 16.

¹⁴ SNKC 1, paragrafi 45.

¹⁵ SNKC 1, paragrafi A54.

- Nënshkrimet e listave të kontrollit të përfunduara që lidhen me procesin e sistemimit.
- Dokumentimi i evidencës së auditimit që audituesi ka siguruar, diskutuar dhe për të cilën ka rënë dakord me anëtarët përkatës të grupit të auditimit, para datës së raportit të audituesit.

A23. SNKC 1 (ose kërkesat në standardet kombëtare që janë të paktën po aq kërkuese) kërkon që firmat të vendosin politika dhe procedura për mbajtjen/ruajtjen e dokumentacionit të angazhimit.¹⁶ Periudha e ruajtjes për angazhimet e auditimit si rregull nuk është më e shkurtër se pesë vjet duke filluar nga data e raportit të audituesit, ose nga data e raportit të audituesit të grupit.¹⁷

A24. Një shembull i rrethanës në të cilën audituesi mund të konsiderojë të nevojshme të ndryshojë dokumentacionin ekzistues të auditimit ose të shtojë dokumentacion të ri auditimi mbasi ka përfunduar sistemimi i dosjes është nevoja për të qartësuar dokumentacionin ekzistues të auditimit që vijnë nga komentet e marra gjatë inspektimeve të mbikëqyrjes të kryera nga palë të brendshme ose të jashtme.

¹⁶ SNKC 1, paragrafi 47.

¹⁷ SNKC 1, paragrafi A61.

Kërkesa dhe Udhëzime Specifike të Dokumentimit të Auditimit në SNA-të e Tjera

Kjo shtojcë identifikon paragrafët në SNA-të e tjera që kanë hyrë në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar më ose mbas datës 15 dhjetor 2009 që përmbajnë kërkesa të veçanta për dokumentimin. Kjo listë nuk zëvendëson marrjen në konsideratë të kërkesave dhe zbatimeve përkatëse dhe materialet e tjera shpjeguese në SNA-të.

- SNA 210, “Rënia Dakord për Kushtet e Angazhimit të Auditimit” – paragrafët 10-12.
- SNA 220, “Kontrolli Cilësisë për Auditimin e Pasqyrave Financiare” – paragrafët 24-25.
- SNA 240, “Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Mashtrimin në Auditimin e Pasqyrave Financiare” – paragrafët 45-48.
- SNA 250 (i rishikuar), “Marrja në Konsideratë e Ligjeve dhe Rregulloreve në Auditimin e Pasqyrave Financiare” – paragrafi 30.
- SNA 260 (i rishikuar), “Komunikimi me Ata që Janë Ngarkuar me Qeverisjen” – paragrafi 23.
- SNA 300, “Planifikimi i Auditimit të Pasqyrave Financiare” – paragrafi 12.
- SNA 315 (i rishikuar), “Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij” – paragrafi 32.
- SNA 320, “Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e Auditimit” – paragrafi 14.
- SNA 330, “Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara” – paragrafët 28-30.
- SNA 450, “Vlerësimi i Anomalive të Identifikuara gjatë Auditimit” – paragrafi 15.
- SNA 540, “Auditimi i Çmuarjeve Kontabël, Përfshirë Çmuarjet Kontabël të Vlerës së Drejtë dhe Dhënia e Informacioneve Përkatëse” – paragrafi 23.
- SNA 550, “Palët e Lidhura” – paragrafi 28.
- SNA 600, “Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Grupit (Përfshirë Punën e Audituesit të Entitetit të Kontrolluar)” – paragrafi 50.
- SNA 610, (i rishikuar 2013), Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm – paragrafët 36-37.
- SNA 720, (i rishikuar), Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera – paragrafi 25.